



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 01.02.2021 ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare komisioni

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për huan për zhvillimin e politikës për qëndrueshmërinë fiskale dhe rritjen në Shqipëri”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Adnor Shameti, Elona Hoxha, Vasilika Hysi, Alket Hyseni, Eglantina Gjermeni, Ervin Bushati, Andrea Marto, Ralf Gjoni, Vasil Sterjovski, Ediola Braha, Zef Shtjefni, Ditmir Bushati, Halit Valteri, Fatmir Velaj dhe Reme Lala

Mungojnë:

Rudina Hajdari dhe Ligoraq Karamelo.

Të ftuar:

Adela Xhemali - Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Elona Mistrovica – Përfaqësuese e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera – Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Fillojmë sot mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme, datë 1 shkurt 2021.

Meqë jemi me 1 shkurt ju uroj muaj të mbarë kolegë, kolege dhe të ftuar!

Sot në rendin e ditës kemi “Ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për huan për zhvillimin e politikës për qëndrueshmërinë fiskale dhe rritjen në Shqipëri”.

Jemi komision për dhënie mendimi, relatore është ministrja Gjermani, të ftuar kemi zonjën Adela Xhemali, zëvendësministre e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Mirë se vjen, zonja zëvendësministre!

Zotin Nikolla Lera, drejtori më i rëndësishëm i ministrisë, dhe zonjën Elona Mistrovica. Mirë se vjen zonjë!

Shumë shkurt zonja zëvendësministre fjala për ju se për çfarë flet marrëveshja e huasë.

Adela Xhemali – E nderuar kryetare,

Të nderuar deputetë,

Projektligji që i kemi paraqitur Kuvendit për shqyrtim dhe miratim synon ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Botërore, më specifikisht Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për huan për zhvillimin e politikës për qëndrueshmërinë fiskale dhe rritjen në Shqipëri.

Tipikisht IBRD-ja u akordon vendeve anëtare dy tipologji kredish njëra nga të cilat është ajo që ne quajmë *project financing*, pra, IRmark kredi dhe, e dyta, është mbështetja buxhetore. Kjo hua që ne po diskutojmë sot vjen në formën e një mbështetjeje buxhetore dhe është hua për zhvillim politikash, konkretisht për zhvillimin e politikave për qëndrueshmërinë fiskale dhe rritjen ekonomike në Shqipëri. Huaja e synuar në vlerën 80 milionë është një mbështetje buxhetore, të cilën BB-ja, bordi i saj, ka vendosur t’ia akordojë Republikës së Shqipërisë në sajë të disa angazhimeve të caktuara, që autoritetet shqiptare kanë ndërmarrë tashmë, ose kanë marrë përsipër të ndërmarrin në vijim sipas një skeduli të caktuar kohor në lidhje me dy aspekte kyçe të zhvillimit të vendit, financat publike dhe rritjen ekonomike. Më specifikisht dhurimi i kësaj huaje për zhvillim politikash është të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë në realizimin e objektivave të mëposhtme, forcimin e transparencës dhe

qëndrueshmërisë së financave publike, përmirësimin e financave për rritje dhe rimëkëmbje, mbështetje për mundësitë sektoriale kryesore për zhvillim të qëndrueshëm.

Risqet e përgjithshme që lidhen me situatën politike dhe qeverisjen, me situatën makroekonomike, me hartimin teknik të programeve dhe me kapacitetin institucional mund të dëmtojnë efektivitetin e reformave strukturore të mbështetura nga ky program dhe për të zbutur këto risqe të përgjithshme, që janë tipike në çdo vend dhe për të siguruar një efektivitet sa më të plotë të reformave strukturore të mbështetura nga kjo hua e zhvillimit të politikave, programi sugjeron që qeveria shqiptare të vijojë bashkëpunimin me BB-në nëpërmjet asistencave teknike në mënyrë që të sigurohemi për plotësimin e kushteve.

Në mbyllje të këtij prezantimi të përmbledhur sjell në vëmendjen tuaj se, së pari, kjo kredi është e parashikuar në buxhetin e vitit 2021, si një nga burimet kryesore të financimit dhe, së dyti, termat financiarë të kredisë janë mjaft të favorshëm, norma e interesit është fiks *libor* 20.8, ndërkohë që maturiteti relativisht afatgjatë, rreth 12 vjet, ndaj do të ftoja anëtarët e nderuar të komisionit që ta miratojnë këtë projektligj, megjithatë jemi të hapur për çdo pyetje.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, Zëvendësministre!

Zonja Gjermani, fjala për ju.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, kryetare!

Faleminderit, zonja Zëvendësministre!

Shpjegimi i zëvendësministres ishte shterues, megjithatë ajo që mund të shtoj është që pa dyshim ratifikimi i kësaj marrëveshjeje huaje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Botërore, më specifikisht Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim me hua prej 80 milionë dollarësh ndikon pozitivisht në rritjen e qëndrueshmërisë fiskale në Shqipëri, uljen e deficitit buxhetor, por pa dyshim edhe rritjen ekonomike në Shqipëri. Duke forcuar si qëndrueshmërinë, ashtu edhe cilësinë e modelit të rritjes së Shqipërisë, programi i reformës i mbështetur nga ky financim pritet të ketë një ndikim pozitiv në uljen e varfërisë në planin afatgjatë, pa dyshim edhe në krijimin e vendeve të punës. Do të ndihmojë Shqipërinë në përmirësimin e financave për rritjen përmes ekonomisë digjitale dhe shfrytëzimit të pasurive natyrore të Shqipërisë, duke përfshirë dhe stimulimin e zhvillimit të modeleve të turizmit, që integrojnë komunitetet lokale. Mendoj që edhe sa upërket efekteve financiare, u shpjegua edhe nga zëvendësministrja, janë të favorshme dhe besoj se do të gjejë mbështetjen e të gjithë kolegëve për ta miratuar këtë marrëveshje huaje, duke shpresuar që vërtetë do të japë një impakt pozitiv në ekonominë shqiptare.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja Gjermani!

A ka pyetje, apo komente?

Nëse nuk ka pyetje nga ju kam unë një pyetje.

Zëvendësministre, a mund të më thoni shkurtimisht se cilat janë kushtet që ka vënë banka me qëllim mirëfunksionimin e marrëveshjes së huasë?

Adela Xhemali – Kushtet janë relativisht të gjera dhe mbështeten në këto shtylla që thamë. Megjithatë pjesa më e madhe e kushteve janë plotësuar tashmë si pjesë të paketës së këtij programi. Ju, të nderuar, keni kaluar në parlament 4 ligje dhe mund t'i përmend: ligji “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, ligji “Për tregjet e kapitalit”, ligji “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe ligji “Për shërbimin e pagesave”. Të gjitha këto ligje janë mbështetje për mirëfunksionimin e programit. Një tjetër masë që është marrë ka qenë publikimi i disa të dhënave nga Ministria e Financave dhe për një nga këto publikime, ndoshta Niko këtu mund të më ndihmojë.

Nikolla Lera – Në lidhje me komponentin e parë ne kemi pasur si detyrim që të thellojmë studimin në bashkëpunim me BB-në, por të gjitha përjashtimet dhe tarifrat e reduktuara duhet të bëhen të qarta për parlamentarët në mënyrë që të llogaritim sa janë humbjet tatimore nga përjashtimet dhe tarifrat të reduktuara. Ne e kemi bërë këtë në buxhetin e 2-3 viteve të fundit, pra në pjesën e fundit të relacionit të buxhetit ne kemi thënë edhe se sa janë shpenzimet tatimore, le të themi 90 miliardë në TVSH, x lekë në tatim fitimi, etj të kësaj natyre. Ndërkohë po vazhdojmë me Bankën Botërore që ta thellojmë dhe ta përmirësojmë këtë studim nëpërmjet futjes edhe të dhënave dhe punonjësve të INSTAT-it për të pasur rezultate sa më të mira. Qëllimi është kjo që thashë, pra secili nga ne, çdo parlamentar dhe çdo shqiptar duhet të jetë i ndërgjegjshëm që këto politika fiskale po i falin publikut, popullit, qytetarit dhe sipërmarrësve x lekë, që nuk mblidhen në buxhetin e shtetit, por u lihen këtyre personave dhe shërben edhe si një mekanizëm që nesër do të përmirësojmë politikën fiskale, pra do të reduktojmë, do të heqim, do të shkurtojmë ato përjashtime, të cilat nuk japin impakt në ekonomi, në jetën e qytetarit, por janë thjesht parazitare. Pra, shërbejnë si një mall shumë i mirë për të riparë politikat që duhet të bëjmë. E dyta, është çështja e rimbursimeve, e cila ka qenë një gangrenë në Shqipëri.

Ne duhet të jemi të ndërgjegjshëm që kjo çështje në pjesën dërrmuese është mbyllur, pra sot në Shqipëri nuk ka fason eksportues, ndërmarrje që punon me material porosites, që nuk e merr rimbursimin brenda afatit ligjor 3 ose 6 ditor. Nuk ka më stok të papaguar, të prapambeturat janë vetëm stoku i 3-4 kompanive, i TAP-it, që nuk mundeshim dhe kemi lidhur marrëveshje për pagesën me këste, e cila do të përfundojë në korrik 2021 dhe që është

futur si pjesë e detyrimeve që kemi për këtë kredi dhe 2-3 subjekte të tjera të mëdha, nuk më kujtohen mirë, që edhe ato janë me marrëveshje me pagesë me këste sipas ligjit, sepse ne futëm edhe në legjislacion. Pra, këta komponentë janë kryesorët që përbëjnë 95% të detyrimeve që kemi dhe ne jemi në zbatim të tyre dhe nuk kemi problematika në informimin e vazhdueshëm siç kërkohet në marrëveshje.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Ju falënderoj!

Po nënkryetar,

Ralf Gjoni – Faleminderit, kryetare!

Kisha një pyetje specifike. Në relacion argumentohet se një nga shtyllat e këtij programi e mbështet Shqipërinë në miratimin e reformave kryesore, që forcojnë transparencën dhe qëndrueshmërinë e financave publike. Ju argumentoni se kjo shtyllë forcon aftësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe uljen e borxhit të qeverisë. Nuk kuptoj një gjë: pse ne vazhdojmë të marrim borxhe për të siguruar transparencë të financave publike dhe për të ulur borxhet? A mund të ma shpjegoni? Se të marrësh 80 milionë dollarë për terma kaq të përgjithshëm, për forcim transparence, më tingëllon më tepër si prioritetet e BE-së që nuk dalin asgjëkund sesa ndonjë gjë specifike.

Adela Xhemali – Në fillim të prezantimit tim unë u mundova të shpjegoja që kjo hua nuk është për një projekt të caktuar, por një mbështetje buxhetore. Në momentin që ne themi se është mbështetje buxhetore, 80 milionë dollarët nuk shkojnë për të arritur këto masa, ato shkojnë për mbulimin e deficitit dhe për çdo shpenzim që është tashmë në buxhetin e shtetit. Nga ana tjetër, të gjitha këto masa do të arrihen me asistencë teknike, pra me grante nga BB-ja në bashkëpunim me qeverinë. Asnjë nga këto para nuk shkon për të arritur masat, është mbulim deficitit.

Mimi Kodheli – Ata nuk japin para për të ngritur një program që të rrisë transparencën, ata injektojnë para për shkak të borxhit publik dhe fakti që ata injektojnë para, automatikisht transparenca rritet, se ata duhet të bëjnë publike më shumë nga sa kanë bërë deri sot, të gjithë treguesit makro, që lidhen me borxhin, jo vetëm me financat publike në përgjithësi.

Ralf Gjoni – E kuptoj kryetare, por mua personalisht më duket pak e tepruar, por flas në përgjithësi, se si politika fiskale e qeverisë orientohet drejt rritjes së borxhit dhe e shoh me shqetësim, besoj që edhe ju si specialistë të ministrisë e kuptoni çfarë dua të them, në plan afatgjatë rritjen graduale të borxhit të shtetit, e cila nuk e di se si do të arrijmë ta shlyejmë në vitet në vazhdim sidomos duke marrë parasysh pandeminë.

Mimi Kodheli – Nuk futemi në diskutim.

Ralf Gjoni – Jo thjesht doja ta përmendja.

Mimi Kodheli – Borxhi nuk është problem për një ekonomi, fuqia paguese e borxhit është, sepse ka vende të zhvilluara të BE-së që kanë dyfishin e borxhit të Shqipërisë.

Ralf Gjoni – E di, por po flas për vende që prodhojnë, ne nuk prodhojmë asgjë.

Mimi Kodheli – Por ka një problem. Vitin më të vështirë historik që ke kaluar nga shumë vite përlllogaritja e rritjes së borxhit ka qenë e moderuar krahasuar me çfarë na është dashur të përballemi.

Ralf Gjoni – Një mendim shpreha.

Mimi Kodheli – Unë e them nga pikëpamja e profesionit që ka në *background*.

Eglantina Gjermani – Mund të them diçka?

Mimi Kodheli – Po, zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Duke kuptuar këndvështrimin e Ralfit dhe duke mos qenë ekonomiste si ju në momentin e parë të krijon këtë përshtypje që duke marrë një borxh tjetër ti e rrit borxhin, por duke e injektuar në ekonomi, duke nxitur industrinë digjitale, turizmin dhe duke forcuar biznesin, ky do të sjellë më shumë të ardhura dhe sigurisht që rrit qëndrueshmërinë fiskale dhe ul deficitin. Mendoj se ka një ndikim pozitiv në ekonomi.

Mimi Kodheli – Atëherë e hedhim në votim ratifikimin e marrëveshjes.

Kush është dakord? Ju lutem, dua të shoh duart tuaj!

Neni 1 i projektligjit.

Kundër? Nuk ka. Abstenon nënkryetari Gjoni.

Faleminderit!

Votojmë në tërësi projektligjin? Ju lutem!

Abstenon nënkryetari Gjoni.

Miratohet.

Punë të mbarë!

Faleminderit, Zëvendësministre!

MBYLLET MBLEDHJA